

VENDIM
Nr.389, datë 27.3.2008

PËR LICENCIMIN E KOLEGJIT PROFESIONAL PRIVAT “LUIGJ BENUSSI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 7, 43, 44 e 45, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e kolegjit profesional privat “Luigj Benussi”, i cili do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Ky kolegji do të ofrojë programin e studimit të ciklit të parë, në formën e studimit me kohë të plotë, i emërtuar “Teknik i lartë laborator”, i cili do të zgjasë 3 (tri) vite, dhe, në mbarim të studimeve, lëshohet diplomë e nivelit të parë.

3. Ngarkohet kolegji profesional privat “Luigj Benussi” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese, të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. Kolegji profesional privat “Luigj Benussi” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programin e studimit, të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se ky institucion privat ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Kolegji profesional privat “Luigj Benussi” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha